



www.italy-ontheroad.it

Safety on the car



SIGURIA NË MAKINË


Të dhëna të përgjithshme




Përdorimi i rripave të sigurimit dhe i karrigeve për transportin e fëmijëve në mënyrë të drejtë, është themelore për të shmangur vdekjet dhe plagosjet në rastet e aksidenteve rrugore. Kjo vlen dhe në oksidentet në qendrat e banuara.



Përdorimi në mënyrë të drejtë rripave të sigurimit dhe vendosja e fëmijëve mbi karriget përkatëse sipas peshës dhe moshës dhe të lidhen në mënyrë të drejtë. Këto masa mund të shpëtojnë jetë ose të shmangin plagosjet në rast aksidenti.




Përplasja me shpejtësi rreth 50Km në orë është e barabartë me rënien nga kati i tretë.



Përplasja me shpejtësi rreth 100 Km në orë është e barabartë me rënien nga kati i 13.

Është me rëndësi të madhe përdorimi i rripave të sigurimit nga gratë shtatzënë. Mos përdorimi i rripave të sigurisë nga ana e grave shtatzëne duhet të shoqërohet me anën e një çertifikate mjeksore ku të provohet rrezikshmëria e përdorimit të tyre.



Rripi i Kuq: Pozicioni jo i rregullt

Rripi i Jeshil: Pozicioni i rregullt dhe jo i rrezikshëm.

Për një transport të sigurt dhe të drejtë për fëmijët.

Në tregtimin e karrigeve të sigurisë për fëmijë ekzistojnë disa lloje, njera nga këto është karrigia me rritje progresive (nga 0 deri në 36kg): Që është më e vështirë për tu montuar dhe nga njëherë zë vend më shumë, por me kalimin e kohës rezulton më ekonomike.




Karrigte për transportin e fëmijëve me probleme shëndetsëore: Kjo karrige përbëhet me një basë rrotulluese deri në 90° për të lehtësuar sistemimin e fëmijës me probleme.



Sistemet isofix: këto sisteme lidhen në mënyrë direkte ne telajon e makinës dhe kanë një sistem çbllokimi të shpejtë: Pikat e favorshme të tyre janë këto që vijojnë më poshtë:


- shmangie të gabimeve gjatë montimit;
- maksimumi i garancisë për sigurinë;
- të përshtatshme për në të gjitha tipat e rripave të sigurisë vetëm për pak tipa janë gjysëm të përshtatshme).
- Mund të montohen (lidhen) në një moment të dytë.



Normat europiane klasifikojnë 4 grupe (ose klase) të karrigeve të përshtatshme për disa tipe fëmijësh të ndarë sipas peshës dhe moshës.

GRUPI 0: deri në 10 kg (nga 0 deri në rreth 9 mujsh).

GRUPI 0+: deri në 13kg.



Djepi në të majtë i përshtatshëm deri në 10 kg (grupi 0) duhet të jëtë i plotësuar me fasha jastiku rreth kokës së fëmisë si dhe me një fashë të veçantë rreth barkut të tij.

Lidhje speciale realizojnë bllokimin e djepit në sedilet e prapme të makinës me anën e rripit të sigurisë me 3 pika lidhje që ndodhet gjithashtu në pjesën e prapme të sediljeve.


Dy karriget në qendër e në të djathtë mund të montohen tek sediljet e përparme por të kthyera me fytyrë nga ana e prapme e makinës, kjo vlen vetëm për makinat që nuk kanë airbag nga ana e pasagjerit.



Duhet të kujtojmë gjithmonë që karrigen duhet ta lidhim në anën e kundërt të lëvizjës së mjetit dhe me airbagët aktiv në pjesën e përparme karriget duhet të lidhen gjithmonë në anën prapme të sedileve.

Duhet të ndërrojmë karrigen vetëm atëherë kur koka e fëmijës ti ketë kaluar bordin e karriges.

Grupi 1: nga kg 9 deri në kg 18 (nga 9 muaj deri në 4-5 vjeç).



Edhe në këtë rast duhet të kalojnë në një grup tjetër me peshë më të madhe vetëm kur koka e fëmijës del jashtë bordit të karriges.

Duhet të kujtojmë që karrigia të lidhet shumë mirë, të shtërngohet rreth sediles që të mos qëndrojë e lirshme sepse rrit rrezikshmërinë për fëmijët në makinë.


Grupi 2: nga kg 15 deri kg 25 (nga 4 vjeç deri në 6-7 vjeç).

Për fëmijët më të mëdhenj karrigia ka funksionin që ti ngrëjë më sipër për ti lidhur dhe shtërnguar më mirë ata.



Edhe për fëmijët e këtij grupi vendi më i sigurtë është ai i sedileve të prapme.

Grupi 3: nga kg 22 deri 36 kg (nga 6 vjeç deri në 12 vjeç).
Deri në 1,5 m gjatësi.



Për fëmijët që nuk arrijnë 1,5 m. gjatësi duhet përdorur një stol dhe një mbështetje e përshtatshme.


Kurse për fëmijët 12 vjeç dhe me 1,5 m gjatësi, rregulli është si për të rriturit në përdorimin e rripit të sigurisë: i cili duhet ti kalojë i mbështetur mirë tek shpatulla dhe tek mesi.

Rripi i sigurisë nuk duhet të vendoset kurrë mbi qafë dhe mbi bark. Mbështetësja e kokës duhet të rregullohet sipas pozicionit të kokës.

Për një transport të sigurtë e të rregullt.



Kg 9-18: sistemi me 5 pika (lidhje) për (rripat e sigurisë me 3 pika) dhe pjesërisht rreth mesit.



Kg 9-18: karrige isofix me rripa me 5 pika (lidhje) ose tavolinë sigurie.



Kg 15-36 stol vetëm për rripat me 3 pika (lidhje).



Kg 9-18: karrige me tavolinë sigurie për rripa me 3 pika (lidhje) ose rripa mesi.



Kg 15-25: sistem sigurie me tavolinë për rripa me 3 pika (lidhje) ose rripa mesi.



Kg 15-36: stol me mbështetje shpine vetëm për rripa me 3 pika (lidhje).

	Klasa 0	Klasa 0+	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3
Pesha	Deri në kg 10	Deri në Kg 13	Nga Kg 9 deri në Kg 18	nga Kg 15 deri në Kg 25	nga Kg 22 deri në Kg 36
Mosha	Deri në 9 muaj	Deri në18 muaj	Nga 9 muaj deri në 4 vjeç	Nga 3 deri në 7 vjeç	Nga 6 deri në 12 vjeç me gjatësi 1,5 m. (*)

(*) maksimumi, pas kësaj konsiderohet i rritur.

Kujtesë: ti përmbaheni udhëzimeve për përdorimin e karrigeve për fëmijët në makinë si dhe në përdorimin e makinës;
rregullo rripat e sigurisë sipas madhësisë së fëmisë;
ripat e sigurisë duhet të jenë të mbështetura dhe të lidhura mirë rreth trupit të fëmisë (hiqni xhupat e fëmijve mbi karrige sepse ulin sigurinë e qëndrimit të tyre mbi karrige).

Vetëm në goftë se përdoret në mënyrë të rregullt karrigia e lidhur me rripat e sigurisë shpëton jetën e fëmisë në makinë.

Datë: 12/08/2015

Thanks to:
Bleta Mimoza and Bleta Arian
Reproduction accepted with indication of source.